



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,
Ref:26.07.2017\563-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Ulpinana Lamës kundër gazetës Koha Ditore**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi ankesën e Ulpinana Lamës kundër gazetës Koha Ditore lidhur me artikullin në dy vazhdime "Rehatimi i bashkëpunëtorëve në MPJ" dhe "Sindikata në mbrojtje të imazhit të shërbimit të jashtëm", botuar më 22 dhe 24 korrik 2017, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë, Ulipana Lama thotë: "nuk kam qenë këshilltare politike, por eksperte me kontratë për detyra specifike brenda periudhës që parasheh ligji, e në bazë të konkursit transparent".

Ankuesja pranon se është kontaktuar nga gazeta Koha Ditore, por pavarësisht përgjigjeve të saja, ajo është futur sërish në listën e këshilltarëve politik.

"Shkrimi është marrë me mua" - thuhet më tej në ankesë - duke "përcaktuar" pozicionin tim si një "prezantuese televizioni", dhe "këshilltare e Agim Çekut".

KMShK, pasi shqyrtoi artikujt me titull: "Rehatimi i bashkëpunëtorëve në MPJ" dhe "Sindikata në mbrojtje të imazhit të shërbimit të jashtëm", të botuar më 22 dhe 24 korrik 2017, ankesën si dhe shpejgimet e përfaqësuesit të Kohës Ditore, konstatoi se gazeta i ka dërguar Ministrisë së Jashtme në Kosovë një listë me pyetje lidhur me çështjet e trajtuara në këta dy artikuj. Të gjitha përgjigjet që i ka marrë gazeta dhe i ka botuar.

Gjithashtu, KMShK pati parasysh përkufizimet ligjore të punonjësve të MPJ-së që ndalojnë të komentojnë çështjet e MPJ-së në media.

Megjithatë, Ulpinana Lama ka dërguar reagimin e saj i cili është botuar nga gazeta Koha Ditore. Gazeta pranoi se ka bërë një gabim teknik të paqëllimtë duke e përzier emrin e Ulpiana Lamës me Alma Lamën, për çka është e gatshme të bëjë edhe korigjimin, mirëpo kjo shkarje teknike është e kuptueshme për çdo lexues.

Gazeta nuk ka qenë e pasaktë duke i përmendur aktivitetet e Ulpiana Lamës në fushën televizive dhe as si ish këshilltare e Agim Çekut para se të bëhej diplomate. Kualifikimet e saj shkencore këtë herë nuk kanë qenë në sferën e interesimit të gazetës, e cila nuk konteston askund përgaditjen e saj profesionale.

Sa i përket statusit të Ulpiana Lamës, gazeta disponon dukimetin zyrtar, në të cilin ajo në listën e pagave figuron si "këshilltare politike".

Gjithashtu gazeta ka të dhëna se gradimi i përmendur në hierarkinë diplomatike të Ulpiana Lamës është bërë pa u plotësuar kushti formal kohor.

Vendimi u mor me shumicën e votave të të gjithë të pranishmëve që nuk ka shkelje të Kodit të Mediave të Shkruar të Kosovës.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMSHK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës